

Statistikat e Transportit Rrugor

Tremujori I, 2025

Tiranë, më 14 Maj 2025: Gjatësia e rrjetit rrugor në shfrytëzim është 3.606* km, klasifikuar sipas kategorive, si autostradë, rrugë interurbane kryesore, rrugë interurbane dytësore, rrugë urbane dhe rrugë lokale.

Në tremujorin e parë 2025, numri gjithsej i mjeteve rrugore me status "aktiv" dhe "të çregjistruar përkohësisht" që qarkullojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë deri në Mars 2025 rezulton 976.916 mjete.

Në kategorinë e mjeteve rrugore sipas llojit, përqindjen më të madhe ndaj numrit gjithsej të mjeteve rrugore e zënë "Autoveturat" (80,8 %), "Automjetet për transport të përzier" (6,0 %) dhe "Motor" (5,8 %).

Tab. 1 Mjetet rrugore sipas llojit

Mjete rrugore sipas llojit	TR I-2024	TR II-2024	TR III-2024	TR IV-2024	TR I-2025
Gjithsej	887.321	914.925	939.152	959.226	976.916
Autoveturë	715.700	738.299	758.690	775.217	789.456
Automjet për transport të përzier	54.627	55.767	56.522	57.544	58.265
Motor	49.377	51.890	53.937	55.279	56.801
Kamion	15.878	16.134	16.296	16.556	16.820
Autobus	8.640	8.758	8.829	8.886	8.962
Automjet për transport të veçantë	8.585	8.832	9.002	9.160	9.328
Automjet për përdorim të veçantë	4.600	4.674	4.759	4.871	4.959
Rimorkio për transport mallrash	1.929	1.972	1.993	2.013	2.039
Të tjera	27.985	28.599	29.124	29.700	30.286

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Ilogaritje INSTAT

Në tremujorin e parë 2025, numri më i lartë i mjeteve rrugore është në qarkun e Tiranës, duke zënë 34,7 % të mjeteve rrugore gjithsej në vend, pasuar nga qarku i Durrësit me 13,5 % të mjeteve rrugore gjithsej.

Qarqet me numrin më të vogël të mjeteve rrugore janë qarku i Gjirokastrës me 2,2 % dhe qarku i Kukësit me 2,4 % të mjeteve rrugore gjithsej.

* Treguesi i gjatësisë së rrugëve dhe klasifikimit të tyre i referohet vetëm rrugëve të cilat janë nën administrimin e ARRSH-së.

Për publikim 14/05/2025

Vijon

Tab. 2 Mjete rugore sipas qarqeve

Qarqet	TR I -2024	TR II -2024	TR III -2024	TR IV-2024	TR I - 2025
Gjithsej	887.321	914.925	939.152	959.226	976.916
Berat	36.032	36.975	37.781	38.684	39.408
Dibër	25.043	25.650	26.419	27.147	27.978
Durrës	119.446	123.590	127.173	130.004	132.201
Elbasan	61.486	62.959	64.674	66.450	67.935
Fier	82.169	84.204	86.391	88.034	89.549
Gjirokastrë	19.429	19.865	20.321	20.735	21.185
Korçë	44.473	45.462	46.610	47.831	48.860
Kukës	20.851	21.364	22.018	22.657	23.184
Lezhë	43.975	44.952	46.220	47.415	48.558
Shkodër	63.093	64.471	65.967	67.309	68.549
Tiranë	307.890	319.545	327.606	333.444	338.712
Vlorë	63.434	65.888	67.972	69.516	70.797

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Ilogaritje INSTAT

Marka “Mercedes Benz” është marka me qarkullim më të lartë në vend në kategorinë e mjeteve rrugore me 18,0 %, e ndjekur nga marka “Volkswagen” me 16,5 % dhe “Daimler Chrysler” 7,9 %.

Tab. 3 Mjete rugore sipas markës

Marka e mjeteve rrugore	TR I -2024	TR II-2024	TR III-2024	TR IV-2024	TR I -2025
Gjithsej	887.321	914.925	939.152	959.226	976.916
MERCEDES BENZ	159.939	164.238	168.615	172.652	175.955
VOLKSWAGEN	141.691	147.535	152.874	157.132	160.802
DAIMLER CHRYSLER	76.726	77.026	77.354	77.541	77.517
FORD	73.120	74.076	74.958	75.543	75.987
AUDI	47.073	49.941	52.771	55.126	57.260
OPEL	35.559	35.977	36.328	36.485	36.603
TOYOTA	36.833	38.145	39.505	40.531	41.368
FIAT	31.544	32.559	32.912	33.188	33.485
BMW	24.929	25.748	26.481	27.125	27.654
RENAULT	19.195	19.311	19.376	19.398	19.419
PEUGEOT	13.831	14.028	14.144	14.216	14.272
NISSAN	14.646	15.016	15.431	15.773	16.025
LAND ROVER	12.092	12.488	13.004	13.430	13.824
MITSUBISHI	10.225	10.538	10.672	10.789	10.861
HYUNDAI	12.423	13.949	15.232	16.302	17.603
CITROEN	10.145	10.591	10.735	10.826	10.917
DAYANG	10.797	11.274	11.804	12.066	12.391
VOLVO	9.181	9.685	10.239	10.760	11.174
SKODA	8.460	8.983	9.225	9.454	9.614
SMART	7.071	7.161	7.242	7.365	7.451
YAMAHA	7.112	7.379	7.594	7.765	7.960
TE TJERA	124.729	129.277	132.656	135.759	138.774

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Ilogaritje INSTAT

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <https://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/transporti-dhe-aksidentet/>

Gjatë tremujorit të parë 2025, janë regjistruar për herë të parë 20.319 mjete rrugore. Në kategorinë e mjeteve rrugore sipas llojit të regjistruar për herë të parë, përqindjen më të madhe e zënë “Autoveturat” me 82,0 %.

Tab. 4 Mjete rrugore sipas llojit, të regjistruara për herë të parë

Mjete rrugore sipas llojit	TR I-2024	TR I-2025	Ndryshimi në %
Gjithsej	21.265	20.319	-4,4
Autoveturë	17.947	16.671	-7,1
Automjet për transport të përzier	769	845	9,9
Motor	1.354	1.533	13,2
Kamion	230	287	24,8
Autobus	104	92	-11,5
Automjet për transport të veçantë	145	164	13,1
Automjet për përdorim të veçantë	65	82	26,2
Rimorkio për transport mallrash	45	32	-28,9
Të tjera	606	613	1,2

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Ilogaritje INSTAT

Numri më i lartë i mjeteve rrugore të regjistruara për herë të parë, është në qarkun e Tiranës, duke zënë 40,0 % ndaj mjeteve rrugore gjithsej të regjistruara në vend për herë të parë në tremujorin e parë 2025. Qarqet me numrin më të vogël të mjeteve rrugore të regjistruara për herë të parë, janë qarqet Gjirokastrë me 1,4 %, Kukës e Dibër me nga 2,4 % secila.

Tab. 5 Mjete rrugore sipas qarqeve, të regjistruara për herë të parë

Mjete rrugore sipas qarqeve	TR I-2024	TR I-2025	Ndryshimi në %
Gjithsej	21.265	20.319	-4,4
Berat	769	709	-7,8
Dibër	384	493	28,4
Durrës	3.381	3.138	-7,2
Elbasan	1.291	1.311	1,5
Fier	1.774	1.760	-0,8
Gjirokastrë	269	282	4,8
Korçë	733	727	-0,8
Kukës	483	483	0,0
Lezhë	832	889	6,9
Shkodër	1.160	1.156	-0,3
Tiranë	8.926	8.129	-8,9
Vlorë	1.263	1.242	-1,7

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Ilogaritje INSTAT

Marka “Volkswagen” është marka me qarkullim më të lartë në vend në kategorinë e mjeteve rrugore të regjistruara për herë të parë me 20,0 %, e ndjekur nga marka “Mercedes Benz” me 17,9 %.

Tab. 6 Mjete rrugore sipas markës, të regjistruara për herë të parë

Mjete rrugore sipas markës	TR I-2024	TR I-2025	Ndryshimi në %
Gjithsej	21.265	20.319	-4,4
VOLKSWAGEN	4.512	4.059	-10,0
MERCEDES BENZ	3.573	3.647	2,1
AUDI	2.320	2.261	-2,5
FORD	999	793	-20,6
TOYOTA	1.216	916	-24,7
DAIMLER CHRYSLER	403	223	-44,7
FIAT	626	440	-29,7
BMW	614	595	-3,1
OPEL	398	322	-19,1
TE TJERA	6.604	7.063	7,0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Ilogaritje INSTAT

Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit në frekuencë tremujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit hekurudhor, tokësor, detar dhe ajror.

Transporti rrugor: Çdo lëvizje e mallrave duke përdorur një mjet rrugor në një rrjet të caktuar rrugor.

Autoveturë - Mjet motorik i transportit rrugor i destinuar për transport pasagjerësh, në të cilin numri i vendeve të uljes (duke përfshirë edhe shoferin) nuk e kalon numrin 9.

Autobus - Mjet motorik i transportit rrugor i destinuar për transport pasagjerësh me numrin e vendeve të uljes (duke përfshirë dhe vendin e shoferit) me më shumë se 9 vende.

Kamion - Mjet i destinuar për transportin e mallrave dhe të njerëzve të caktuar me përpunimin ose transportin e këtyre mallrave.

Motor - Mjet motorik i transportit rrugor me dy, tre ose katërt rrota që nuk i kalon 400 kg peshë pa ngarkesë.

Rimorkio për transport mallrash - Mjet rrugor për transportin e mallrave i projektuar për t'u tërhequr nga një mjet motorik i transportit rrugor.

Automjete për transport të përzier (ATP) - Përfshihen mjetet që kanë një peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë jo më të madhe se 3.5 tonë, ose 4.5 tonë kur ka tërheqje elektrike me bateri; janë të destinuara për transport njerëzish dhe mallrash me kapacitet maksimal nëntë ndenjëse, duke përfshirë dhe ndenjësen e drejtuesit të mjetit.

Automjete për transport të veçantë (ATV) - Mjet transporti i destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të vecanta dhe karakterizohet nga pajisja në mënyrë të përbashkët, me mekanizma special që i shërbejnë këtij qëllimi.

Automjete për përdorim të veçantë (APV) - Mjete të pajisura në mënyrë të përhershme me mekanizma të vecantë dhe të destinuar përgjithësisht për transportin e këtyre mekanizmave; mbi këto automjete lejohet transporti i personelit dhe i materialeve që kanë lidhje me ciklin operativ të këtyre mekanizmave, si dhe transporti i njerëzve dhe mallrave që kanë lidhje me destinacionin e përdorimit të këtyre mekanizmave.

Eksportet: Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend iparë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Importet: Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend iparë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Të dhënat e transportit rrugor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <https://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/transporti-dhe-aksidentet/>